



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 94/2017

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionerëve Publikë është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Komisionerëve Publikë është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 29.9.2017

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Funksioni organik	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KOMISIONERI PUBLIK		(4)
Komisionerë Publikë	G3*	2
Sekretarë	Sekretar në kabinetin e ministrit**	2
II. KANCELAR	I-b	(1)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(6)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	4
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	2
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(7)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie	IV-a	2
Specialist redaktor gjuhësor	IV-b	1
Përkthyes	II-b	1
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(8)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll/arkiv	IV-b	1
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer	V	1
Gjithsej		26

Shënim:

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për pozicionin e sekretarit është sipas VKM nr. 187/2017.